

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

3646  
Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Peshkopi, më 08.09.2025

**Lënda:** Dërgim vendimi

**Drejtuar:** Prefekti i Qarkut Diber

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Diber Nr. 42

**Datë:** 03.09.2025 si dhe projekt-vendimin nr.03 Datë 27.08.2025.

**“PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT PËR “RIKONSTRUKSIONIN TOTAL TË ÇATISË DHE NDËRTIMIT TË TUALETEVE TË REJA TË SHKOLLËS GRYKË-NOKË”.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.801/1 prot.

Peshkopi, më 10.09.2025

**Lënda:** Për vendimin nr.42, datë 03.09.2025 të Këshillit Bashkiak Dibër.

**BASHKISË DIBËR**  
**KËSHILLIT BASHKIAK DIBËR**

**DIBËR**

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit për efekt ligjslunërie të vendimit të Këshillit Bashkiak Dibër nr.42, datë 03.09.2025 **"Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit për "Rikonstruksionin total të çatisë dhe ndërtimit të tualeteve të reja të shkollës Grykë-Nokë "**, vendosa:

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën përkatëse, nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër që paraqesin për miratim projekt akte të kësaj natyre.

**PREFEKTI**

Nexhbedin SHEHU





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

**VENDIM**

**Nr. 42 Datë 03 / 09 /2025**

**“PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT PËR “RIKONSTRUKSIONIN TOTAL TË ÇATISË DHE NDËRTIMIT TË TUALETEVE TË REJA TË SHKOLLËS GRYKË-NOKË”.**

Bazuar në ligjin nr.139/2015 Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Ligjin nr.44/2015 Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Ligjin nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, Marrëveshjes së bashkëpunimit datë 04/06/2025 mes Vizion OJF dhe Bashkisë Dibër, Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e datës **03.09.2025** me 17 vota pro 0 kundër 3 apstenim :

**VENDOSI:**

1. Të miratojë marrëveshjen e bashkëpunimit për “Rikonstruksionin total të çatisë dhe ndërtimin e tualeteve të reja në shkollën Gryk-Nokë.
2. Të miratojë vlerën e projektit në shumën 5.380.000 lekë, e cila ndahet donatori OJF në vlerën 4.304.000 lekë ndërsa Bashkia Dibër në vlerën 1.076.000, vlerë e cila do planifikohet në projekt buxhetin e vitit 2026.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit , Drejtoria Ekonomike, Bashkia Dibër.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
5. Vendimi u shpall më datë **03.09.2025**.

**Zyrtar i Kryetar i Këshillit Bashkiak**  
**Mario FEJZA**



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**BASHKIA DIBËR**  
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**  
**P/ VENDIM**

Nr. 03 date 21/08 / 2025

**“Për miratimin e marrëveshjes së bashkpunimit për “Rikonstruksioni total i çatisë dhe ndërtimi i tualeteve të reja të shkollës Grykë-Nokë ”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, Ligji nr.44/2015 Kodi I Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Ligji nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, Marrveshjes së Bashkpunimit datë 04.06.2025 mes Vizion OJF dhe Bashkisë Dibër.

**KËRKOJMË:**

1. Te miratoje marrëveshjen e bashkpunimit për “Rikonstruksionin total i çatisë dhe ndërtimi i tualeteve të reja në shkollën Grykë-Nokë”.
2. Te miratojë vlerën e projektit në shumen 5.380.000 lekë, e cila ndahet donatori OJF në vlerën 4.304.000 lekë ndërsa Bashkia Dibër në vlerën 1.076.000, vlerë e cila do planifikohet në project buxhetin e vitit 2026.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria Ekonomike.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Keshillit Bashkiak Diber dhe shprehjes për bazueshmeri ligjore nga institucionit të Prefektit të Qarkut Diber.

**Drejtori Dpzh**  
Blerina Mazari



**Drejtori Juridik**  
Ismet SARACI



**Drejtori Ekonomik**  
Çeljta ZUNA



**KRYETARI I BASHKISE**  
Rahim SPAHIU

**ME URDHER DHE ME POROSI**

**ZV/KRYETARI**

**Lorenc CIBAKU**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



VIZION O.J.F

Nr. 60/06/2025 Prot.

Datë 06/06/2025



BASHKIA DIBËR

Nr. 2370/1 Prot.

Datë 06/07 2025

## AKT – MARRËVESHJE

Sot, më datë 06.06.2025, kjo Akt - Marrëveshje lidhet ndërmjet palëve:

Shoqata “**Vizion O.J.F**”, me adresë: *Rr. Panajot Pano, pallati Lin Construction, ndërtesa 27, Yzberisht Tiranë*, me numër Nipt-i: K81810452I, e përfaqësuar nga **znj. Suela KOÇIBELLINJ** në cilësinë e Drejtorit ekzekutiv të shoqatës.

### ***Dhe***

**Bashkia Dibrë**, *person juridik*, me adresë: Adresa: Bulevardi “Elez Isufi”, Peshkopi, Nipt: K46908711M përfaqësuar nga Kryetari Bashkisë **Z. Rahim SPAHIU**

Qëllimi i marrëveshjes ndërmjet palëve, është bashkëfinancimi i projektit “**Rikonstruksioni total i çatisë dhe ndërtimi i tualeteve të reja të shkollës Grykë-Nokë**”, zbatimi i punimeve përkatëse, për ofrimin e kushteve më të mira për fëmijët/nxënësit dhe stafin.

Ky bashkëpunim është kontribut i drejtpërdrejtë për të gjithë banorët e zonës, mbi parimet e gjithëpërfshirjes, pa dallime fetare apo politike.

**Palët bien dakord të hartojnë këtë akt-marrëveshje me kushtet dhe kriteret e mëposhtme:**

### **NENI 1**

#### **Baza Ligjore**

- 1.1 Kjo akt-marrëveshje bazohet në nenin 9 pika 1.6, nenin 23, nenin 36 dhe nenin 64 gërma “a” dhe “gj” të ligjit Nr. **139/2015** “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenet 79 e vijues të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” (i ndryshuar).

## NENI 2

### Objekti i Marrëveshjes

- 2.1 Objekti i kësaj marrëveshje është bashkëfinancimi i projektit me objekt: **Rikonstruksioni total i çatisë dhe ndërtimi i tualeteve të reja të shkollës Grykë-Nokë**, me qëllim ofrimin e kushteve më të mira për fëmijët dhe stafin si edhe një kontribut i drejtpërdrejtë për të gjithë banorët e zonës, mbi parimet e gjithëpërfshirjes, pa dallime fetare apo politike, nga palët në marrëveshje me donator “Shoqata VIZION O.J.F” me partner “International Project Aid” IPA Zvicër, në rolin e financuesit, dhe palës përfituese Bashkia Dibër në rolin e bashkëfinancuesit.
- 2.2 Vlera e financimit për realizimin e projektit **“Rikonstruksioni total i çatisë dhe ndërtimi i tualeteve të reja të shkollës Grykë-Nokë”**, sipas kushteve të kësaj marrëveshje do të jetë:

Vlera totale e financimit të projektit do të jetë: **5.380.000 (pesë milion e treqind e tetëdhjetë mijë lekë) me TVSH**

Nga të cilat:

- Donatori Vizion O.J.F me partner International Projekt AID (IPA) merr përsipër të mbulojë kostot në vlerën **4.304.000 (katër milion e treqind e katër mijë) lekë me TVSH, fond limit**
- Përfituesi Bashkia Dibër, do të bashkëfinancojë për punimet në objekt sipas preventivit **në shumën prej 1.076.000 (një milion e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë me TVSH** (pra 20 % të shumës totale të domosdoshme)

## NENI 3

### Kushtet e Marrëveshjes

- 3.1 Në lidhjen e kësaj marrëveshjeje ekziston pëlqimi i palëve në marrjen përsipër të detyrimeve përkatëse, shkakun e ligjshëm në të cilin mbështeten detyrimet dhe objekti që formon lëndën e marrëveshjes.
- 3.2 Akt-Marrëveshja quhet e vlefshme meqenëse palët kanë shfaqur dhe shprehur në mënyrë të ndërsjelltë vullnetin e tyre, duke u marrë vesh për të gjitha kushtet thelbësore të saj.
- 3.3 Në këtë akt-marrëveshje, palët shprehin dhe garantojnë që shkak i ligjor i lidhjes së saj nuk është i paligjshëm, nuk vjen në kundërshtim me ligjin, rendin publik si dhe marrëveshja nuk shërben si mjet për të shmangur zbatimin e një norme të legjislacionit shqiptar.

**NENI 4**  
**Detyrimet e palëve në marrëveshje**

**4.1** Pala, shoqata **“Vizion O.J.F”** në rolin e Donatorit / financuesit, merr përsipër:

- a) Në rolin e Donatorit të projektit të mbulojë kostot e domosdoshme për realizimin e projektit dhe të përmbushë detyrimet financiare që rrjedhin nga implementimi i të gjitha fazave të projektit, në përputhje me Buxhetin dhe planin e investimit.
- b) Të kontraktojë një sipërmarrës të licensuar sipas legjilacionit në fuqi për kryerjen e punimeve të ndërtimit që ka marrë përsipër në bazë të zërave të preventivit, në përputhje me vlerën e financuar, si edhe likuidimin e shpenzimeve financiare
- c) Të bashkëpunojë me Bashkinë Dibër, partner përfitues për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta, të planifikuara në Projekt.
- d) Të bashkëpunojë me Bashkinë Dibër me qëllim maksimizimin e impaktit të projektit.
- e) Të propozojë projekt-ide bashkë me partnerin International Projekt Aid, në të mirë të zhvillimit të zonës.
- f) T'u përmbahet afateve sipas marrëveshjes që lidhet me firmën e ndërtimit

**4.2** Pala, **Bashkia Dibër** në rolin e pronarit përfitues / bashkëfinancues merr përsipër:

- a) Të zbatojë si partner bashkëpunues projektin në fjalë dhe të përmbushë detyrimet ligjore dhe financiare që rrjedhin nga implementimi i të gjitha fazave të projektit, në përputhje me Buxhetin, Planin e Aktiviteteve
- b) Të kontraktojë një sipërmarrës të licensuar sipas legjilacionit në fuqi për kryerjen e punimeve që ka marrë përsipër në bazë të zërave të preventivit, në përputhje me vlerën e financuar, si edhe likuidimin e shpenzimeve financiare
- c) Të sigurojë lejet dhe autorizimet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi për prishjen e çatisë së vjetër dhe për ndërtimin e çatisë së re, si edhe ndërtimin e tualeteve
- d) Të kontraktojë mbikëqyrësin e punimeve, kolaudatorin e punimeve dhe marrjen në dorëzim të punimeve , për të gjitha punimet që do të realizohen nga secila palë në marrëveshje
- e) Të bashkëpunojë me donatorin, shoqatën Vizion O.J.F me partner “International Projekt Aid” për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta në vijim
- f) Të asistojë e kontrollojë ecurinë e punimeve, si edhe të administrojë dokumentacionin teknik të zbatimit të punimeve
- g) Të jetë transparente me donatorin në çdo fazë të zbatimit të projektit
- h) Të lehtësojë angazhimet në territorin e Bashkisë Dibër për donatorin
- i) Të lejojë Vizion O.J.F dhe partnerin “International Projekt Aid” të realizojnë kontrole të herëpashershme pas mbylljes së projektit.
- j) Të mbështesë Vizion O.J.F dhe partnerin “International Projekt Aid” për të realizuar projekte të tjera zhvillimore në këtë zonë.
- k) T'u përmbahet afateve sipas marrëveshjes që lidhet me firmën e ndërtimit

## **NENI 5**

### **Kohëzgjatja**

- 5.1 Kohëzgjatja e kësaj akt-marrëveshje përcaktohet për një periudhë: duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët, deri në përfundimin e plotë të realizimit të projektit objekt marrëveshje.

## **NENI 6**

### **Modifikime dhe shtesa të Akt-Marrëveshjes**

- 6.1 Modifikimet dhe shtesat që i bëhen kësaj akt – marrëveshje janë të vlefshme vetëm nëse janë me shkrim dhe të nënshkruara nga të dyja palët.
- 6.2 Akt-marrëveshja nuk mund të ndryshohet në mënyrë të njëanshme nga palët nënshkruese.

## **NENI 7**

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

- 7.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet palëve gjatë zbatimit të kësaj akt-marrëveshje, palët do të njoftojnë me shkrim njëra-tjetrën, brenda 5 ditëve dhe do të angazhohen për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve.
- 7.2 Në rast se Palët nuk arrijnë t'i zgjidhin mosmarrëveshjet me mirëkuptim, atëherë do t'i shtrohen për zgjidhje gjykatës kompetente sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

## **NENI 8**

### **Njoftime**

- 8.1 Të gjitha njoftimet dhe komunikimet mes palëve do të bëhen me shkrim dhe do të dërgohen me postë rekomandë, ose me anë të një shërbimi korrier, me fax ose dorazi, në adresat e mëposhtme:

8.2

#### **Për Bashkinë Diber**

Adresa: Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi.

Email: [bashkia.diber@dibra.gov.al](mailto:bashkia.diber@dibra.gov.al)

#### **Për Shoqatën "Vizion O.J.F"**

Adresa: Rr. Panajot Pano, pallati Lin Construction, Ndërtesa 24, Yzberisht, Tiranë.

Email: [info@vizionojf.org](mailto:info@vizionojf.org)

## NENI 9

### Tërësia dhe Interpretimi i Akt-marrëveshjes

- 9.1 Kjo akt – marrëveshje do të interpretohet duke konsideruar afatet dhe kushtet e saj në tërësi. Në çdo rast, secili nen apo formulim që do të krijojë paqartësi do të vlerësohet në kontekstin e të gjithë akt-marrëveshjes dhe në lidhje me qëllimet që kanë nxitur të dyja palët për të lidhur këtë akt-marrëveshje.
- 9.2 Nëse ndonjë nga pikat e kësaj akt-marrëveshje është ose bëhet e pavlefshme, e paligjshme dhe e pamundur për t'u ekzekutuar, ajo do të veçohet nga akt-marrëveshja. Pavarësisht nga kjo, të gjitha parashikimet e tjera të akt-marrëveshjes do të mbeten në fuqi dhe do të prodhojnë pasoja për palët. Asnjë pikë e kësaj akt-marrëveshjeje nuk do të varet nga ndonjë pikë tjetër përveç në rast të kundërt kur parashikohet nga kjo akt-marrëveshje.


## NENI 10


### Dispozita të fundit

- 10.1 Kjo Akt – Marrëveshje pranohet me të gjitha kushtet dhe termat e saj, dhe hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.
- 10.2 Kjo akt-marrëveshje u formulua në 4 (katër) kopje origjinale, nga të cilat 2 (dy) për shoqatën “Vizion O.J.F”, dhe 2 (dy) kopje origjinale për Bashkinë Dibër.

### PALËT NË AKT-MARRËVESHJE

Bashkia Dibër  
  
Z. Rahim SPAHË



Shoqata “Vizion O.J.F”  
  
Znj. Suela KOÇIBELLINJ

